



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 134, Datë 09.07.2024

MBI

ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME LICENCIMIN E SHOQËRISË “H.K. HEC GRABOVA 2” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 996/5 prot., datë 04.07.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “H.K HEC GRABOVA 2” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “GRABOVA 2”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “H.K HEC Grabova 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 996 prot., datë 25.04.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Grabova 2”, me kapacitet prodhues 10.8 MW, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, Qarku Elbasan.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr.87, datë 09.05.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “H.K HEC Grabova 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.05.2024 dhe 13.05.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të

tretët (data 10.06.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 996/3 prot., datë 20.05.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria me shkresën me nr. 996/4 prot., datë 03.06.2024, ka përcjellë dokumentacionin plotësues të aplikimit, i cili gjendet në pjesët respektive të këtij relacioni.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesë më të lartë se ajo që kërkohet për një njësi gjeneruese, sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores, ndaj në vijim do të bëhen sistemimet përkatëse me departamentin e financës.
- Sa rezulton nga dokumentacioni i depozituar nga shoqëria, lind nevoja për saktësime/sqarime në lidhje me afatet e ndërtimit dhe vënies në punë të hidrocentralit, në referencë të përcaktimeve të kontratës së Koncesionit nr. 2026 rep., nr. 926/1 kol., datë 14.09.2017, për ndërtimin e hidrocentralit “GRABOVA 2”, e ndryshuar. Për këtë qëllim dhe në mbështetje të nenit 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 14, pika 3 e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me licencimin e shoqërisë “H.K HEC Grabova 2” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjen përfundimtare të bordit të ERE-s në lidhje me licencimin e shoqërisë “H.K. HEC GRABOVA 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Grabova 2”, me kapacitet total të instaluar 10.8 MW, me vendndodhje në pellgun e përroit të Grabovës, Gramsh, Qarku Elbasan.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI